



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 78 prot.

Kamëz, më 18.6.2021

V E N D I M

Nr. 64 .Datë 18.6 2021

MBI

Propozim për miratimin e shumës financiare prej 600.546 (gjashtëqindmijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë, (me tvsh) për familjen e shtetasit Fran Kol Paçuku.

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot më 18.06.2021 në kushte të veçanta si pasojë e masave të ndërmarra për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 , pasi mori në shqyrtim **Projekt – Nr.55 Datë 16.06.2021** në mbështetje të Ligjit Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji, Nr. 45/2019 “Për Mbrojtjen Civile, VKM-së Nr. 329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore” V.K.B Kamëz Nr. 60, datë 23.12.2019 “Për Miratimin e Buxhetit për vitet 2020, 2021 dhe 2022, struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606, *Urdhërit të punës titullarit të bashkisë nr.279 prot, dt.26 05.2021*”Për evidentimin, konstatimin si dhe vlerësimin e dëmeve si pasojë e djegies së banesës së z.Fran Paçuku me datë 22.05.2021 **Këshilli Bashkiak Kamëz**”;

V E N D O S I :

1. Miratimin e shumës financiare prej 600.546(gjashtëqindmijë e pesëqind e dyzet e gjashtë) lekë,(me tvshpër shtetasin Fran Kol Paçuku, banor i rrugës“Bulevardi Blu” Kamëz, të cilit i është dëmtuar banesa si pasojë e djegies nga zjarri,rënë në banesën e tij më datë 22.05.2021
2. Shuma 50.000 (pesëdhjetemijë) lekë, si ndihmë emergjente të mbulohet nga buxheti i Bashkisë Kamëz struktura buxhetore: Gr0, Kap05, Progr. 03280, Art. 606, viti 2021 ndërsa shuma prej 550.546(pesëqind e pesëdhjete mijëcë pesëqind e dyzet e gjashtë)lekë me tvsh do të përballohet nga fondet e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile duke qenë se bashkia nuk ka fonde te mjaftueshme per ta mbuluar vete gjithë shumën e nevojshme
3. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

Nën/ Kryetar Këshilli
Ali Dauti